

VENDIM

Nr. 603, datë 23.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 8 e 13 të vendimit nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi ...” zëvendësohen me “... me indeksin e çmimeve të konsumit ...”.
2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Sali BERISHA